

**NJOFTIM PËR ZHVILLIMIN E
ASAMBLESË SË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË
WVP FUND MANAGEMENT TIRANA SH.A**

Të nderuar aksionerë,

Me anë të këtij njoftimi dëshiroj t'ju bëj me dije se në datë 09 Maj 2018 ora **16:00** në zyrën e WVP në adresën : Rruga Barrikadave, Nderresa 18 H.6 Ap.11, Tiranë, Shqipëri, do të zhvillohet Mbledhja e Asamblesë së aksionarëve të shoqërisë WVP Fund Management Tirana!

Në rend të ditës së mbledhjes së asamblesë së aksionerëve janë për diskutim dhe vendimarrje çështjet e mëposhtme:

1. Miratimi i pasqyrave financiare të audituara për vitin 2017
2. Zgjedhja e Ekspertit Kontabël të Shoqërisë për vitin 2018
3. Të ndryshme

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës bashkëlidhur këtij njoftimi keni dokumentacionin e nevojshëm. Në lidhje me pikën e dytë lutemi që nëse aksionerët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë mendojnë se ka diçka për të diskutuar, të paraqesë mendimin e tyre në adresë të administratorit (kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike) si dhe dokumentacionin përkatës që mendon se është i nevojshëm tu shpërndahet aksionerëve paraprakisht, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes.

Ju sjell në vëmendje se për të marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së aksionerëve, aksionerët duhet të paraqiten në ditën dhe orën e përcaktuar më sipër, në selinë e shoqërisë, sipas adresës së përcaktuar më sipër. Aksionerët mund të paraqiten dhe të marrin pjesë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar. Si përfaqësues i aksionerit mund të jetë një aksioner tjetër apo një person i tretë. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionerëve në asamblenë e përgjithshme.

Njoftimin e mbledhjes dhe dokumentacionin përkatës mund ta gjeni edhe në faqen web të shoqërisë në adresën në internet www.wvpfunds.al

Zotërimi i aksioneve aktualisht në shoqëri është si vijon:

- WVP Fund Management AD Shkup, person juridik i themeluar dhe regjistruar në shtetin maqedonas, me nr të regjistrimit tregtar 6938120, me seli ne Vasil Glavinov, nr.14-1/8 Shkup Qender, zotëron [51%] ([pesëdhjetë e një përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 5100 aksione.
- WVP-Ndërmjetësim në Sigurime sh.a Tirana, person juridik i themeluar dhe regjistruar në shtetin shqiptar, me nr të regjistrimit tregtar K62324003M, me seli Rruga Barrikadave, Nderresa 18 H.6 Ap.11, Tiranë, zotëron [25%] ([njëzet e pesë përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 2500 aksione.
- Z.Arton Lena zotëron [15%] ([pesëmbëdhjet përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 1500 aksione.
- Z.Rupert Strobl zotëron [4%] ([katër përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 400 aksione.
- Z.Kujtim Ibraimi zotëron [2.5%] ([dy pikë pesë përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 250 aksione.
- Z.Ardian Kelmendi zotëron 2.5% ([dy pikë pesë përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 250 aksione.

Numri i votave në asamblenë e aksionerëve, që ka secili aksioner është i barabartë me numrin e aksioneve që zotëron secili prej tyre.

Për sa më sipër, lutemi që çdo kërkesë të paraqitet në adresë të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë z.Arton Lena, në selinë e shoqërisë.

Lutemi konfirmoni marrjen e njoftimit për zhvillimin e mbledhjes së asamblesë.

Administrator
Arton Lena